URDHËR
Nr. 163, datë 14.8.2026

PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE DHE DETYRAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Z. Ervis Gjoshi, me gradën Kryekomisar, caktohet të ushtrojë kompetencat dhe detyrat e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në lidhje me funksionimin administrativ dhe drejtimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse në fushën e përgjegjësisë së MZSH-së.
2. Në ushtrimin e detyrave të përkohshme, siguron vazhdimësinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së dhe ushtron kompetencat e nevojshme për garantimin e funksionimit normal të saj, në kufijtë e kompetencave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Ky urdhër qëndron në fuqi deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të MZSH-së ose deri në shfuqizimin e tij.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari